

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR FOND ZA ZDRAVSTVENO OSIGURANJE
HEALTH INSURANCE FUND
Nësisia Org. Org. Jedinica Org. Unit. FSSH Nr. Prot. 794
Nr. I faqeve Br. stranica No. pages - 16- Data Datum 05.05.2023
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravlja – Ministry of Health
Fondi për Sigurime Shëndetësore – Fond Zdravstvenog Osiguranja – Health Insurance
Fund

Nr. 07/16
Datë: 18 prill 2023

Bazuar në Ligjin për Sigurim Shëndetësor Nr. 04/L-249, neni 32, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-042, si dhe nenit 7 të Statutit të Fondit për Sigurim Shëndetësor. Bordi Drejtues i Fondit për Sigurim Shëndetësor, në mbledhjen e mbajtur me datë: 18 prill 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti vjetor i punës së Fondit për Sigurim Shëndetësor për vitin 2022.
2. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.


Dafina Gexha-Bunjaku
Kryesuese e Bordit Drejtues

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Bordit Drejtues të FSSH-së
- Sekretarisë së Bordit Drejtues të FSSH-së
- Arkivit të FSSH-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government
Fondi për Sigurime Shëndetësore – Fond Zdravstvenog Osiguranja – Health
Insurance Fund

RAPORTI VJETOR I PUNËS
FONDI PËR SIGURIM SHËNDETËSOR
JANAR - DHJETOR
2022



TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	3
1.1. Sistemi i kontrollit të brendshëm.....	4
1.2. Divizioni Ligjor.....	4
1.3. Komunikimi dhe raportimi.....	5
1.4. Auditimi i brendshëm.....	5
1.5. Burimet njerëzore.....	6
2. BUXHETI	6
2.1. Shpenzimet	8
2.2. Trajtimet mjekësore jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (TMJIShP).....	10
2.3. Procesi i barazimeve me institucionet shëndetësore	11
3. SISTEMI I INFORMIMIT TË FONDIT (SIF)	12
4. SHËRBIMET FARMACEUTIKE	13
5. SHËRBIMET SHËNDETËSORE	13
6. SFIDAT	14



1. HYRJJE

Fondi i Sigurimeve Shëndetësore (“FSSh”) është një organizatë e buxhetore e financuar nga buxheti shtetëror dhe i themeluar me Ligjin Nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor (“Ligji për Sigurimin Shëndetësor”). Misioni i FSSh është ofrimi i sigurimit shëndetësor për qytetarët e vendit.

FSSh udhëhiqet nga Bordi Drejtues (“BD”) i cili emërohet sipas nenit 8, paragrafit 8 të Ligjit për Sigurimin Shëndetësor. Me vendim të Qeverisë nr. 09/86, të datës: 04.07.2022, është emëruar Bordi Drejtues me këtë përbërje: znj. Dafina Gexha-Bunjaku, nga Ministria e Shëndetësisë; z. Ahmet Ismaili, nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; z. Klit Shala, nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; z. Kastriot Meqa, përfaqësues i Odës së Profesionistëve Shëndetësor; znj. Agreta Gashi, përfaqësuese e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës; z. Fahri Shabani, përfaqësues i Asociacionit të Komunave të Kosovës; z. Muhamedali Kodra, përfaqësues nga shoqatat e Pacientëve- me mandat tre-vjeçar. Në mbledhjen e parë të Bordit Drejtues, sipas parimit të rrotacionit, janë zgjedhur përkatësisht, znj. Gexha-Bunjaku dhe z. Shala, kryesuese dhe zëvendës-kryesues të Bordit Drejtues- me mandat një-vjeçar (me rotacion).

Në mbledhjen e parë, të mbajtur më 21.07.2022, BD ka vendosur që drejtorin e mëparshëm ta largoj përkohësisht nga detyra. Në krye të FSSh, si zëvendësues, është emëruar sekretari i BD të FSSh, njëherit edhe drejtori i Divizionit ligjor në FSSh, vendim i cili pasohet me vendimmarje finale pas shqyrtimit të të gjitha dokumentacioneve dhe informacioneve përkatëse.

Gjatë analizimit në vazhdim u konstatua se ishin raportuar plotësisht të gjitha borxhet, përkatësisht detyrimet kontingjente gjatë zbatimit të Programit për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (“Programi TMJIShP”), duke rezultuar në një rritje të detyrimeve të gjithmbarshme Fondit, që vjen nga lëshimi i fletëzotimeve dhe mos evidentimi/shpalosja e tyre. Ky borxh kontingjent i pa-raportuar dhe pa shpalosur deri atëherë është vlerësuar të jetë mbi 31 milionë euro i cili shumëfish (mbi 4 herë) kalon ndarjet buxhetore vjetore që financohet vetë Fondi. Fondi ka borxhe kontingjente që duhet kuptuar si borxhe të mundshme, që Fondi mund të obligohet t’i paguajë në të ardhmen nëse plotësohen disa kushte të caktuara, kushte këto jashtë ndikimit të menaxhmentit të Fondit.

Gjatë vitit 2022 Komiteti i Auditimit ka shqyrtuar katër raporte të auditimit të brendshëm, ku janë nxjerrë 23 konkluzione (11 për përmirësimin e qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm, 1



për sistemin e rrezikut dhe 11 për funksionimin e njësisë së auditimit të brendshëm) dhe ka dhënë 7 rekomandime konkrete si ndihmë për vendimmarrje dhe përmirësim të proceseve.

Ligji për Sigurim Shëndetësor Nr. 04/L-249, neni 32 përcakton: *Bordi Drejtues shqyrton raportet e rregullta vjetore dhe tre (3) mujore me deklaratën financiare, raportet e auditimit, si dhe raportet plotësuese mbi aktivitetin e Fondit.*

Bazuar në këtë, është hartuar raporti vjetor si dhe raportet plotësuese mbi aktivitetet e realizuara të Fondit.

Planifikimi i aktiviteteve është bërë duke marrë parasysh të gjitha burimet me të cilat disponon Fondi për Sigurim Shëndetësor, përfshirë burimet njerëzore dhe ato financiare.

Në mungesë të Planit të punës për vitin 2022 Fondi për Sigurim Shëndetësor ka vazhduar me administrimin e programit për trajtim jashtë vendit si një ndër aktivitet kryesore.

Miratimi i planit të punës për vitin 2023 do të kontribuojë në realizimin e misionit të Fondit i cili është krijimi i qëndrueshmërisë financiare dhe blerja e shërbimeve shëndetësore.

1.1. Sistemi i kontrollit të brendshëm

Sistemi i kontrollit të brendshëm në Fond ka shënuar përmirësim për të mundësuar kontrole sa me efektive për adresimin e rreziqeve dhe ofrimin e sigurisë së arsyeshme lidhur me arritjen e rezultateve në realizimin e objektivave të Fondit. Megjithatë, ende ka sfida që kërkojnë adresim nga ana e menaxhmentit.

1.2. Divizioni Ligjor

Divizioni Ligjor gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 ka vazhduar në ofrimin e shërbimeve profesionale që bien në fushëveprimin e tij. Gjatë vitit, Janar-Dhjetor janë pranuar dymbëdhjetë (12) padi, nga të cilat tri (3) prej tyre me kërkesën për kompensimin e mjeteve nga marrëdhënia e punës, ndërsa nëntë (9) padi janë ushtruar me kërkesën për kompensimin të shpenzimeve të trajtimit në kuadër të programit për TMJISHP.

Po ashtu, ka ofruar ndihmë profesionale përmes bashkëpunimit me Zyrën e Avokaturës Shtetërore në kontestet gjyqësore ku palë në procedurë ka qenë Fondi.

Në të njëjtën kohë, gjatë këtij viti ka mbajtur kontakte të rregullta me Departamentin Ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me Planin Legjislativ 2022 si dhe ka marrë pjesë në shumë komisione dhe grupe tjera të emëruara nga drejtori që kanë të bëjnë me çështje të rekrutimit, disiplinimit dhe ankesave.



1.3. Komunikimi dhe raportimi

Në funksion të organizimit dhe menaxhimit efikas, drejtuesit e Fondit në praktikën e punës dhe administrimit kanë instaluar praktika organizative që mundësojnë planifikim, bashkërendim dhe mbikëqyrje efikase. Në aspektin e komunikimeve të brendshme, Fondi ka ndërtuar një komunikim efektiv me punonjësit, duke ofruar mundësi për secilin punonjës të shprehet hapur si në nivelin hierarkik ashtu edhe brenda departamenteve për çështjet që lidhen natyrën e punës së tyre.

Zëvendësuesi i Drejtorit të Fondit mban takime të rregullta me udhëheqësit e departamenteve, në të cilat diskutohet dhe raportohet lidhur me aktivitetet operative të realizuara si dhe për aktivitetet e planifikuara për periudhën e ardhshme. Më pas, udhëheqësit e departamenteve mbajnë takime me stafin e tyre të cilët informohen mbi çështjet kryesore lidhur me institucionin.

1.4. Auditimi i brendshëm

Bazuar në planin vjetor të auditimit për vitin 2022, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka realizuar të gjitha objektivat e parashikuara në planin e saj për vitin 2022.

Auditimet e përfunduara janë të bazuara në fushat me rrezik më të lartë, si:

- Trajtimet mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore;
- Ndërlidhja e SIF dhe shkëmbimi i të dhënave;
- Barazimet financiare me Institucionet Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore; dhe
- Financat dhe Shërbimet e Përgjithshme.

Auditimet e brendshme kanë rezultuar me ofrimin e rekomandimeve për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe për funksionimin sa më efikas në departamentet përkatëse.

Menaxhmenti pas pranimit të raporteve ka hartuar planet e veprimit dhe ka monitoruar proceset implementimit të rekomandimeve të dhëna.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka hartuar planin strategjik të NJAB 2023-2025 si dhe planin vjetor të auditimit për vitin 2023 i cili është bazuar në vlerësimin e rreziqeve, përkatësisht auditimet janë përcaktuar në fushat që i ekspozohen me shumë rreziqe.



1.5. Burimet njerëzore

Stafi i Fondit në fund të muajit dhjetor 2022 ishte në 41 punonjës, prej tyre:

- Në kuadër të Zyrës së Drejtorit të Fondit- 4 punonjës;
- Departamenti për Shërbime Shëndetësore- 9 punonjës;
- Departamenti për Shërbime Farmaceutike- 6 punonjës;
- Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme- 13 punonjës;
- Divizioni për informim dhe bashkëpunim- 2 punonjës;
- Divizioni i Burimeve Njerëzore- 3 punonjës;
- Divizioni Ligjor- 2 punonjës;
- Divizioni i prokurimit- 1 punonjës;
- Njësia e Auditimit të Brendshëm- 1 punonjës.

Vlen të theksohet se në listën e pagave gjithashtu janë të përfshirë edhe 6 anëtarët e Bordit Drejtues.

Gjatë kësaj periudhe raportuese stafi i Divizionit për Burime Njerëzore ka vazhduar me menaxhimin e dosjeve të personelit si dhe ka organizuar trajnime për stafin e Fondit sipas kërkesave nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike nga lëmi të ndryshme.

2. Buxheti

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, Fondit i janë ndarë 8,162,998€.

Tabela 1. Ndarjet buxhetore të Fondit për vitin 2022

Kategoritë ekonomike	Administrata	Trajtimi Mjekësor Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore	Gjithsej buxheti për vitin 2022
Paga dhe shtesa	411,746		411,746
Mallra dhe Shërbime	458,052		458,052
Shpenzime komunale	23,200		23,200
Subvencionet dhe transferet		7,270,000	7,270,000
Shpenzimet kapitale	0		0
Gjithsej	892,998	7,270,000	8,162,998

Nga Tabela nr. 1 mund të shihet se nga gjithsej buxheti fillestar për vitin 2022 në vlerë 8,162,998, vlera prej 7,270,000€, ose afro 90% e totalit të buxhetit, ishte ndarë për kategorinë



ekonomike Subvencione dhe Transfere, përkatësisht për programin TMJIShP, ndërsa pjesa tjetër për shërbimet administrative të Fondit.

Në kuadër të raportimit të Obligimeve mujore pranë Ministrisë së Financave kemi përgatitur edhe raportin e Detyrimeve Kontingjente që rrjedhin nga Fletëzotimet e lëshuara nga Drejtori i Fondit si dhe vlera e aplikimeve të rregullta që pritet të aprovohen nga Bordi për TMJIShP. Në kuadër të kësaj vlere, shuma prej 9.6 milion€ është krijuar gjatë vitit 2022, siç tregon tabela 6 në këtë raport.

Tabela 2. me poshtë tregon gjendjen e obligimeve të krijuara si the atyre qe janë në proces të vlerësimit (Fletzotimet dhe rastet e rregullta) me datë 31 dhjetor 2022.


1. Obligime financiare në bazë të vendimeve të Bordit për TMJIShP	2,838,505.52
2. Aplikimet urgjente – Fletëzotimet	26,268,806.85
3. Aplikimet të rregullta në pritje për shqyrtim nga Bordi për TMJIShP	2,527,631.09
Total	31,634,943.46

Kjo ka paraqitur sfidë për Fondin sepse për çdo vit kalendarik për programin TMJIShP-ve aplikojnë rreth 1,000 pacientë¹ dhe mesatarja e shpenzimeve për shkak të referimeve të shumta nga klinikat e ShSKUK-s është shumë më e lartë në raport me ndarjet buxhetore për këtë program. Kjo ka shkaktuar që detyrimet e Fondit për këtë program të rriten nga viti në vit.

¹ Sipas Udhëzimit Administrativ Neni 4. Aplikimi për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike, pika 1. "Çdo qytetar dhe banor/shtetas i Republikës së Kosovës ka të drejtë të aplikojë në programin për TMJISHP kur shërbimi i caktuar shëndetësor nuk ofrohet në institucionet publike shëndetësore, në pajtim me dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ".



Figura 1. Ndarjet buxhetore sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



2.1. Shpenzimet

Tabela 3. Shpenzimet në periudhën janar-dhjetor 2022 në raport me buxhetin e alokuar për periudhën e njëjtë si dhe buxhetin vjetor

Kodi	Kategoritë ekonomike	Ndarjet buxhetore	Buxheti i alokuar në periudhën janar-dhjetor 2022	Shpenzimet për periudhën janar-dhjetor 2022	Shpenzim i i buxhetit në %
11324	Paga dhe shtesa	411,746	411,746	341,756.43	83%
	Mallra dhe shërbime	458,052	458,052	187,452.12	41%
	Shpenzime komunali	23,200	23,200	16,880.23	73%
	Shpenzime kapitale	0	0	0	0%
71600	Transfere dhe Subvencione	7,000,000	7,000,000	5,582,350.61	80%
78900	Transfere dhe Subvencione	270,000	270,000	0	0%
Total		8,162,99	8,162,998	6,128,439.39	75%




Nga tabela më lartë mund të shihet se nga gjithsej buxheti i ndarë për vitin 2022 në vlerë 8,162,998€, në periudhën janar-dhjetor janë shpenzuar 6,128,439.39€ ose afro 75% e buxhetit total. Shpenzimet janë bërë në pajtueshmëri të plotë me rregullat e Thesarit.

Pamundësia e shpenzimit të buxhetin në masën 100% ka ndodhur për shkak të kërkesës për auditimin e lëndëve në programin për trajtim jashtë vendit.

Sa i përket buxhetit në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi jo i kënaqshëm ka ndodhë për shkak të disa faktorëve:

1. Për arsye se Bordi Drejtues i FSSH-s ka qenë jo funksional deri në korrik 2022, nuk është arritur të aprovohet plani i punës 2022 dhe si rrjedhojë shpenzimet që do të krijoheshin nga një pjesë e këtyre aktiviteteve (grupe punuese, komisione) nuk janë realizuar;
2. Fondi nuk ka praktikuar shpenzimet e reprezentacionit;
3. Gjatë vitit 2022 nuk është arritur të rekrutohen stafi i ri dhe si rrjedhojë shpenzimet përcjellës nga kategoria mallra dhe shërbime nuk kanë ndodhur;
4. Shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit, shpenzimet e mirëmbajtjes, furnizim për zyre dhe shpenzimet e karburantit në vitin 2022 nuk ishin të larta.

Figura 2. Shpenzimet në periudhën janar-dhjetor në raport me buxhetin e alokuar për periudhën e njëjtë si dhe buxhetin vjetor. Në buxhetin për vitin 2022 linjë e veçantë buxhetore ishte programi i TMJISHP për viktimat e dhunës seksuale të luftës së fundit. Buxheti i ndarë për këtë kategori ishte 270,00.00€. Meqenëse deri në fund të muajit nëntor nuk kishte asnjë aplikim nga kjo kategori, buxheti në vlerë 270,000.00€ përgjatë procesit buxhetor është bartur në kuadër të buxhetit të rregullt për programin e TMJISHP.





2.2. Trajtimet mjekësore jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (TMJIShP)

Programi TMJIShP është program i themeluar me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në rastet kur Institucionet Shëndetësore Publike nuk mund të ofrojnë shërbime të tilla. Funksionimi i këtij programi është i rregulluar me Udhëzim Administrativ 03/2017 në të cilin janë të parapara procedurat e përfitimit nga ky program.

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2022, kanë aplikuar 1099 pacientë për TMJIShP, prej tyre 524 raste urgjente dhe 575 raste elektive.

Tabela 4. Kërkesat dhe lëndët e aprovuara për periudhën Janar- Dhjetor 2022

Nr.	Përshkrimi	Janar- Dhjetor 2021	Janar- Dhjetor 2022	Diferenca
1	Aplikime	1124	1099	-25
2	Raste urgjente	673	524	-149
3	Raste të rregullta	451	575	124
4	Aprovime nga Bordi për TMJIShP	522	672	150

Tabela 5. Aplikimet për TMJIShP në periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022 në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2021

Nr.	Klinika	Nr. i aplikimeve Janar- Dhjetor 2021	Nr. i aplikimeve Janar- Dhjetor 2022	Diferenca
1	Oftalmologji	93	82	-11
2	Pediatri	165	145	-20
3	Hematologji	96	117	21
4	Ortopedi	180	132	-48
5	Kirurgji torakale	34	23	-11
6	Onkologji	5	36	31
7	Neurologji	36	41	5
8	Neurokirurgji	80	42	-38
9	ORL	52	42	-10
10	Urologji	55	52	-3
11	Gastroenterologji	14	5	-9
12	Kardiologji	33	22	-11
13	Neonatalogji	22	36	14
14	Mjekësi nukleare	36	71	35
15	Nefrologji	31	25	-6



16	Kirurgji vaskulare	26	16	-10
17	Pulmologji	5	5	0
18	Radiologji	90	156	66
19	Kirurgji abdominale	16	5	-11
20	Te tjera	55	45	-10
Gjithsej		1124	1099	-26

Tabela 6. Është paraqitur numri i fletëzotimeve të lëshuara brenda vitit 2022, ku edhe është shprehur edhe në vlerë të përafërt financiare meqenëse shuma e saktë dihet vetëm në momentin që këto fletëzotime shndërrohen në vendime nga ana e Bordit për TMJIShP. Ndërsa, nga 524 kërkesa për fletëzotime, pesëdhjetë e nëntë (59) kërkesa për lëshimin e fletëzotimeve janë refuzuar me arsyetimin se diagnoza për të cilën janë referuar për trajtim jashtë vendit nuk është në listën e diagnozave e cila është pjese përbërëse e Udhëzimit Administrative 03/2017 për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike, kurse 465 janë aprovuara siç paraqitën në tabelën nr. 6.

Tabela 6: Fletëzotime të lëshuara në vitin 2022.

Përshkrimi	Nr.	Shuma (€)
Fletezotime 2022	465	9,612,714.33
Fletëzotime të aprovuara 2022	62	1,140,601.24
Fletëzotime në pritje për aprovim 2022	403	8,472,113.09
Fletëzotime (me vendime), të paguara 2022	55	1,095,093.15

Nga 465 fletëzotime brenda vitit 2022, 345 (74%) prej tyre janë lëshuar nga menaxhmenti i kaluar, ndërsa 120 (26%) nga menaxhmenti aktual.

Nga 120 fletëzotime të lëshuara nga menaxhmenti aktual, për 55 prej tyre (46%) janë realizuar pagesat në bazë të vendimeve të aprovuara nga Bordi për TMJIShP.

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2022 në kuadër të TMJIShP janë parashtruar gjithsej dyzet e shtatë (47) ankesa në Komisioni e ankesave për trajtim jashtë vendit, ku katër (4) prej tyre



janë aprovuar nga Komisioni i ankesave dhe ato lënde janë kthyer për ri-shqyrtim në Bordin për trajtim jashtë vendit.

2.3. Procesi i barazimeve me institucionet shëndetësore

Me vendimin e datës 23 shkurt 2019, Drejtori i Fondit ka themeluar Komisionin për Barazime Financiare ndërmjet Fondit dhe Institucioneve Shëndetësore Private brenda dhe jashtë vendit. Sipas vendimit, komisioni ka për obligim që të marrë në shikim, kontrolloj dhe verifikoj tërë dokumentacionin në lidhje me secilën kërkesë individuale për programin TMJIShP, pavarësisht vendit ose kohës së realizimit të kërkesës. Dokumentacioni i pranuar verifikohet kundrejt të dhënave dhe informatave që komisioni ka në dispozicion dhe/ose do të pranoj nga IShP-të brenda dhe jashtë vendit.

Nga viti 2019-2023 janë barazuar 54 institucione shëndetësore private me 3,124 transaksione dhe vlera e mjeteve të lira të dala nga ky proces ishte 1,444,303€ (vlera prej 113,117€ që është përfshirë në totalin e mjeteve të lira është vlerë e mbetur e pashfrytëzuar nga raportet e viteve paraprak).

Komisioni ka bërë barazimet edhe me 4 institucione me 404 transaksione dhe vlera e mjeteve të lira të identifikuar 379,461€.

Tabela 7. Spitalet me të cilat Fondi ka përfunduar procesin e barazimeve gjatë vitit 2019-2023

Nr.	Nr. i Institucione Shëndetësore Private të barazuara	Numri i shërbimeve	Vlera totale e pagesave	Vlera e mjeteve të lira
1	54	3,124	10,992,763	1,444,303 €

Tabela 8. Spitalet me të cilat Fondi ka përfunduar procesin e barazimeve gjatë vitit 2021-2023, por nuk kanë pranuar nënshkrimin e raportit

Nr.	Nr. Institucionet Shëndetësore Private të barazuar	Numri i shërbimeve	Vlera totale e pagesave	Vlera e mjeteve të lira
1	4	404	2,560,531	379,461€



Procesi i barazimeve vazhdon deri në përmbylljen e barazimeve me të gjitha institucionet shëndetësore ku shtetasit e Kosovës kanë marr shërbimet e nevojshme shëndetësore.

3. Sistemi i Informimit të Fondit (SIF)

Në kuadër të kësaj periudhe raportuese, Departamenti i Menaxhimit të Teknologjisë së Informacionit (DMTI) ka vazhduar realizimin e aktiviteteve të planifikuara dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe sistemeve të Teknologjisë Informative për funksionim sa më efikas drejt kryerjes së shërbimeve dhe sigurimit të infrastrukturës së nevojshme harduerike për shfrytëzimin e aplikacioneve softuerike dhe sistemeve informative nga zyrtarët e Fondit, si dhe palët që shfrytëzojnë sistemet tona.

Në përgjithësi është bërë administrimi i sistemeve të informacionit, instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve të reja (Server, Switch, VoIP telefon, Desktop PC, UPS), mirëmbajtja dhe menaxhimi i pajisjeve harduerike dhe softuerike si dhe menaxhimi i adresave të email-ave për stafin.

Mirëmbajtja e ndërlikimeve të Sistemit të Informimit të Fondit me sisteme të institucioneve të tjera ka vazhduar dhe janë përditësuar të dhënat e regjistrave.

4. Shërbimet Farmaceutike

Në kuadër të periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2022, Departamenti për Shërbimet Farmaceutike ka realizuar aktivitetet e prezantuara si në vijim:

- Pjesëmarrje aktive në grup punues për hartimin dhe finalizimin e Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale;
- Pjesëmarrje aktive në komisionin për hartimin dhe finalizimin e Projektligjit për rregullimin e çmimeve të produkte medicinale;
- Pjesëmarrje aktive në grup punues për plotësim/ndryshimin e Ligjit për Sigurime Shëndetësore;
- Pjesëmarrje në grup punues për identifikimin e rreziqeve; hartimin e Rregulloreve, Procedurave dhe Formularëve të nevojshëm për përdorimin e SIF;
- Bashkëpunim i vazhdueshëm me Divizionin e Farmacisë pranë MSh-së rreth përcaktimit të çmimeve të produkteve medicinale nga Lista e Barnave Esenciale;
- Pjesëmarrje aktive në Komitetin e Menaxhmentit të Lartë të Projektit të Shëndetësisë Kosovare;



- Bashkëpunim i vazhdueshëm me Institucionet relevante, përfshirë këtu Agjencinë Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM); Divizionin e Farmacisë pranë Ministrisë së Shëndetësisë, Odën e Farmacistëve të Kosovës (OFK) etj.

5. Shërbimet Shëndetësore

Në kuadër të periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2022, Departamenti për Shërbime Shëndetësore ka realizuar aktivitetet e prezantuara si në vijim:

- Pjesëmarrja në takimet e rregullta të Këshillit Kosovare për Udhërrëfyes dhe Protokolle Klinike.
- Pjesëmarrja në Grupin punues për hartimin e Planit të veprimit për furnizim të qytetarëve me proteza, ortoza dhe shërbime të tjera të cilat ofrohen në ShKOP/ShSKUK.
- Pjesëmarrja dhe kontributi në Komisionin për Kostimin e politikave të hartuara nga MSh ose institucionet vartëse, i themeluar nga ZSP;
- Pjesëmarrja dhe kontributi në Grupin punues për hartimin e Strategjisë Sektoriale Shëndetësore, i themeluar nga ZSP;
- Pjesëmarrja dhe kontributi në Grupin punues për Planin Zhvillimor të Kosovës, i themeluar nga ZSP;
- Pjesëmarrja në takimet e rregullta të menaxhmentit të Fondit;
- Shqyrtimet e ankesave nga Komision i Ankesave të Fondit;
- Kontributi në ekipin menaxhues të kontratës për mirëmbajtjen e SIF;

6. Sfidat

Ngritja dhe konsolidimi i Fondit të Sigurimit Shëndetësor është projekt multisektorial. Funksionalizimi varet nga shumë institucione të ndërlidhura dhe atë: Ministrisë së Shëndetësisë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Agjencia e Regjistrimit Civil, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Komunave dhe Institucioneve shëndetësore të të gjitha niveleve. Secila nga këto institucione ka rolin e vet në funksionalizimin e Fondit dhe krijimin e sistemit të sigurimit shëndetësor.



Prej gjithë hisedarëve, rolin thelbësor në funksionalizmin e Fondit e ka Ministria e Shëndetësisë si institucion politikëbërës.

Ndër sfidat kryesore të Fondit të Sigurimit Shëndetësor janë:

- Mos miratimi i infrastrukturës së nevojshme ligjore e cila do të ndikonte në përafrimin e plotësimit të parakushteve për implementimin e skemës së sigurimeve shëndetësore;
- Trajnimi jo i vazhdueshëm i Stafit të Fondit;
- Referimet e shumta nga Klinikat e ShSKUK-s për trajtim jashtë vendit, jashtë listës së patologjive/procedurave;
- Obligimet dhe detyrimet kontingjent në kategorinë subvencione dhe transfere (Programi për TMJIShP)
- Vonesat në miratimin e plotësim/ndryshimit të UA 03/2017 për TMJIShP. Përfundimi i këtij dokumenti do të korrigjonte shumë të mangësi të identifikuara në udhëzimin aktual e sidomos revidimin e listës së patologjive/procedurave mjekësore të cilat do të mbështeten financiarisht nga Fondi i Sigurimit.

Prishtinë, Mars 2023